

**Halliburton B.V- Degë e një shoqërie të huaj  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

**PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
<b>PASQYRAT FINANCIARE:</b>	
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>2</b>
<b>PASQYRA E PERFORMANCES</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL</b>	<b>4</b>
<b>PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE</b>	<b>5</b>
<b>SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE</b>	<b>6 - 16</b>

**Halliburton BV – Albanian Branch**

(Vlerat janë në '000 Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar**

Deri më 31 dhjetor 2018

	Shënimë	<b>Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017</b>
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	17,794	12,496
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	368,435	82,664
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura		54,790	9,036
Të tjera llogari të arkëtueshme		4,474	-
Inventari	6	82,135	36,771
<b>Te ardhurat e llogaritura</b>	7	<b>360,902</b>	<b>21,830</b>
<b>Total Aktive Afatshkurtra</b>		<b>888,529</b>	<b>162,798</b>
<b>Aktivet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	8	225,963	124,897
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	9	56,136	96,800
<b>Total aktive afatgjata</b>		<b>282,099</b>	<b>221,697</b>
<b>Total Aktive</b>		<b>1,170,628</b>	<b>384,495</b>
<b>DETYSIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	10	287,633	14,203
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura		30,721	491,733
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	11	52,362	1,041
Detyrime tatimore	12	54,554	3,102
Provigionje	13	25,596	-
<b>Te tjera detyrime</b>		<b>161</b>	<b>-</b>
<b>Total Detyrime afatshkurtra</b>		<b>451,027</b>	<b>510,079</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14	1,019,252	-
<b>Total Detyrime afatgjata</b>		<b>1,019,252</b>	<b>-</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>1,470,279</b>	<b>510,079</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Humbje të akumuluara		(125,585)	(79,241)
Humbja e vtit		(174,066)	(46,343)
<b>Total kapitali aksionar</b>		<b>(299,651)</b>	<b>(125,585)</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>1,170,628</b>	<b>384,495</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Halliburton BV – Albanian Branch**

(Vlerat janë në '000 Lek)

**Pasqyra e Performancës**

**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

Shenime	<b>Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017</b>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	1,065,176
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	16	(124,717)
Të tjera shpenzime	17	(859,539)
<b>Shpenzime të personelit</b>	<b>18</b>	<b>(69,675)</b>
1) Paga dhe shpërblime		(67,371)
Shpenzime të sigurimeve		(20,431)
2) shoqërore/shëndetësore		(2,304)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(175,844)
<b>(Shpenzime) / te ardhura financiare, neto</b>	<b>19</b>	<b>(9,468)</b>
(Shpenzime) / fitim nga kursi i kembimit		(9,468)
<b>Humbja para tatimit</b>		<b>(174,066)</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>		-
<b>Humbja e vtit</b>		<b>(174,066)</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

- Humbjet e akumuluara


Totali

	Humbjet e akumuluara	Totali
<b>Pozicioni finanziar më 31 dhjetor 2016</b>	(79,241)	(79,241)
Humbja e vittit	(46,343)	(46,343)
<b>Pozicioni finanziar më 31 dhjetor 2017</b>	(125,584)	(125,584)
Humbja e vittit	(174,066)	(174,066)
<b>Pozicioni finanziar më 31 dhjetor 2018</b>	(299,651)	(299,651)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.  
Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 u aprojuan dhe u nënshkruan si më donishë:

Dario Magedeth  
Perfektues Tigro i Debetos

NIP/T: \* TIRANA - ALBANIA \*  
HALLIBURTON BV \* Halliburton Branch \*  
Albanian Branch



**Halliburton BV – Albanian Branch**

(Vlerat janë '000 në Lek)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	<b>Shënimë</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Humbja e viti		(174,066)	(46,343)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:			
Vlera kontabël e aseteve të dala jashtë përdorimi		(1,573)	(3)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		175,844	39,230
<b>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</b>			
Rritje / (rënje) në të drejtat e arkëtueshrme dhe të tjera		(675,070)	88,146
Rritje në inventarë		(45,364)	(4,020)
Rënje / (rritje) në detyrimet e pagueshme		(59,052)	94,377
<b>Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>		(779,282)	171,387
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktiviteti i investimit</b>			
Pagesa / (të ardhura) për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(275,337)	1,214
<b>Mjete monetare neto nga/ (përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		(275,337)	1,214
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktiviteti i financimit</b>			
Të ardhura / (pagesa) nga kompania Mëmë		40,665	(19,101)
<b>Hua / (pagesa) të arkëtuara</b>		1,019,252	(145,490)
<b>Mjete monetare neto nga / (përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		1,059,917	(164,591)
Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		5,298	8,010
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		12,496	4,487
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>4</b>	<b>17,794</b>	<b>12,496</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## **Halliburton BV – Albanian Branch**

### **Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në '000 Lek)

#### **1. Informacion i përgjithshëm**

Dega ne Shqiperi e Halliburton B.V. (më poshtë si Dega), është Dega në Shqipëri e shoqërisë së huaj Halliburton B.V.

Dega është regjistruar më datë 24 Shtator 2013, dhe është pajisur me NIPT L32124010K me seli ne Rr. "Ibrahim Rugova", Sky Tower Business Center, Kati 10, zyra 103, Tiranë.

Veprimtaria e Degës është: a) Ofrimi i shembimeve b) Shperndarja e mallrave ne industrine e kerkimit te naftes dhe te gazit c) Importi dhe eksporti i lendeve plase të perdorim civil ne Republikën e Shqiperise.

Numri i punonjësve të Degës më 31 Dhjetor 2018 është 16 punonjës.

#### **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

##### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standarde Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpaljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

##### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

##### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Degës përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Dega do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

##### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Degës.

##### **2.5. Vlerësimet dhe gjykime**

Paraqitura e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Degës të kryejë vlerësimet dhe supozimet që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimet e aktiveve e detyrimet të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financier, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjera duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të janë të arsyeshme në rrëthanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësimet dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë rishikimet rëndëssishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimet janë përshkruar më poshtë:

###### **2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimet bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve.

## Halliburton BV – Albanian Branch

### Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në '000 Lek)

Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

#### 2.5.2. Provisionet

Provisionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Dega vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në tilla raste Dega provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

#### 2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Sic paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvèc rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

### 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

#### 3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2018	2017
Euro/ALL	123.24	132.95
USD/ ALL	107.82	111.10

#### 3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përvèç sic përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njoftueshme instrumentat financiarë jo-derivativë maten sic përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Dega bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur Dega transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Dega angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

## Halliburton BV – Albanian Branch

### Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në '000 Lek)

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Degës skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

#### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimi si vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Dega nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financier konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimi si mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferençë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

#### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjetave monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjera jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financier konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivit.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financier, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## Halliburton BV – Albanian Branch

### Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në '000 Lek)

#### 3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale

##### i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Dega do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jeta e dobishme e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma vjetore e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Mjete transporti	Vlerë e mbetur	20 %
Instrumenta the vegla pune	Vlerë e mbetur	20 %

##### iv. Çregjistroimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### 3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e

## Halliburton BV – Albanian Branch

### Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në '000 Lek)

drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëherëshme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

#### 3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### 3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

#### 3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### 3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 eshte 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferenca e tatimit mbi fitimin të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferenca e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferenca ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normal tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferenca e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferenca e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për diferenca në fjalë.

#### 3.10. Fondet për pensione

Dega paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridikcionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

## **Halliburton BV – Albanian Branch**

### **Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në '000 Lek)

#### **3.11. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqites së pasqyrave financiare, drejtimi i Degës dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### **3.12. Provizonet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Dega ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizonet rimerren.

#### **3.13. Aktivet dhe Detyrimet e Kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**Halliburton BV – Albanian Branch****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në '000 Lek)

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Llogari rrjedhese Raiffeisen Bank Lek	369	3,269
Llogari rrjedhese Raiffeisen Bank Euro	17,425	9,227
	<b>17,794</b>	<b>12,496</b>

**5. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Klientë	356,440	70,644
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	54,790	9,036
Parapagime	11,995	12,021
	<b>423,225</b>	<b>91,701</b>

**6. Inventari**

Inventari më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Inventari	82,135	36,771
	<b>82,135</b>	<b>36,771</b>

**7. Të ardhura te perllogaritura**

Të ardhurat e llogaritura detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Të ardhura të llogaritura	360,902	21,830
	<b>360,902</b>	<b>21,830</b>

**Halliburton BV – Albanian Branch**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
(Vlerat janë në '000 Lek)

**8. Aktive Afatgjata Materiale**

<i>Kosto</i>	<i>Machinery, Equipment &amp; Tools</i>		<i>Total</i>
	<i>Gjendja më 31 Dhjetor 2016</i>	<i>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</i>	
Shtesa	189,295	189,295	189,295
Nxjerje jashtë përdorimit	1,699	1,699	1,699
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>(6,993)</b>	<b>184,001</b>	<b>(6,993)</b>
Shtesa	278,483	278,483	278,483
Nxjerje jashtë përdorimit	(2,595)	(2,595)	(2,595)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>459,889</b>	<b>459,889</b>	<b>459,889</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>			
<i>Gjendja më 31 Dhjetor 2016</i>	<i>23,955</i>	<i>23,955</i>	<i>23,955</i>
Amortizimi i vitiit	39,230	39,230	39,230
<b>Nxjerje jashtë përdorimit</b>	<b>(4,081)</b>	<b>(4,081)</b>	<b>(4,081)</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>59,104</b>	<b>59,104</b>	<b>59,104</b>
Amortizimi i vitiit	175,844	175,844	175,844
<b>Nxjerje jashtë përdorimit</b>	<b>(1,022)</b>	<b>(1,022)</b>	<b>(1,022)</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>233,926</b>	<b>233,926</b>	<b>233,926</b>
<i>Vlera neto kontabë!</i>			
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>165,340</b>	<b>165,340</b>	<b>165,340</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>124,897</b>	<b>124,897</b>	<b>124,897</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>225,963</b>	<b>225,963</b>	<b>225,963</b>

**Halliburton BV – Albanian Branch**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
(Vlerat janë në '000 Lek)

**9. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Llogaritë e arkëtueshme nga palët te lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Të drejta dhe detyrime nga kompania Mëmë	56,136	96,800
	<b>56,136</b>	<b>96,800</b>

**10. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Furnitorë	287,633	14,203
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	30,721	491,733
	<b>318,534</b>	<b>505,936</b>

**11. Shpenzime të përllogaritura**

Të pagueshmet për shpenzime të përllogaritura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Shpenzime të përllogaritura	52,362	1,041
	<b>52,362</b>	<b>1,041</b>

**12. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Tatimi mbi vlerën e shtuar	49,215	991
Tatim ne burim	2,396	-
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	1,994	1,600
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	706	511
Te tjera tatime per tu paguar dhe per tu kthyer	242	-
	<b>54,544</b>	<b>3,102</b>

**13. Provigion per raport kontrollin tatimor**

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Provigion per raport kontrollin tatimor	25,996	-
	<b>25,996</b>	<b>-</b>

**14. Te pagueshme ndaj paleve te lidhura**

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Llogari te pagueshme ndaj palet e lidhura	1,019,252	-
	<b>1,019,252</b>	<b>-</b>

**15. Të ardhura nga shitja**

**Halliburton BV – Albanian Branch****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Vlerat janë në '000 Lek)

Të ardhurat nga shitja detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	546,195	185,792
Të ardhura nga shitja e materialeve	157,949	43,457
Të ardhura të përllogaritura	361,032	21,830
	<b>1,065,176</b>	<b>251,079</b>

**16. Materiale të para dhe të konsumueshme**

Materiale të para dhe të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Kosto te shitjeve	(124,717)	(48,720)
	<b>(124,717)</b>	<b>(48,720)</b>

**17. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Shpenzime të tjera	(443,160)	(98,739)
Shpenzime qiraje dhe personeli	(334,363)	(101,688)
Provigion per kontrollin tatimor	(25,596)	-
Shërbime konsulencash	(18,248)	(18,421)
Sherbime doganore	(16,056)	(5,782)
Tatime dhe taksa	(14,005)	(3,186)
Shpenzime sigurimi	(3,813)	(55)
Penalitete dhe te tjera te panjohura	(2,349)	(381)
Shpenzime të lidhura me automjetet	(855)	(767)
Shpenzime transporti	(627)	(534)
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	(468)	(121)
	<b>(859,539)</b>	<b>(229,674)</b>

**18. Shpenzime personeli**

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Shpenzime për pagë	(67,371)	(20,431)
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	(2,304)	(1,763)
	<b>(69,675)</b>	<b>(22,194)</b>

**19. Të ardhura/shpenzime financiare, neto**

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financier të Degës. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

**Halliburton BV – Albanian Branch**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
(Vlerat janë në '000 Lek)

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Fitime nga kurset e kembimit	3,722	56,917
Humbje nga kurset e kembimit	(12,978)	(14,127)
Sherbime Bankare	(212)	(394)
	<b>(9,468)</b>	<b>42,396</b>

**20. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<b>31 Dhjetor 2018</b>	<b>31 Dhjetor 2017</b>
Humbja kontabël per vitin	(174,066)	(46,343)
Shpenzime të panjohura	119,689	23,138
<b>Humbja (përfshirë shpenzimet e panjohura)</b>	<b>(54,377)</b>	<b>(23,205)</b>
Humbje fiskale e mbartur	(7,774)	(77,165)
Humbja fiskale totale	(62,151)	(100,370)
Tatim fitimi @15%	-	-
<b>Humbja per periudhen</b>	<b>(174,066)</b>	<b>(46,343)</b>

**21. Angazhime dhe pasiguri**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Dega mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërise, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financier të Degës ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2018, Dega nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

**22. Ngjarje pas bilancit**

Pas 31 Dhjetor 2018, por përparrë përfundimit të pasqyrave financiare, Dega ishte subjekt i një kontrolli tatimor, i cili përfundoi në Gusht 2019. Kontrolli tatimor mbuloi sa më poshtë:

- Auditimin e TVSH-së për periudhën Nëntor 2014 deri më Korrik 2018;
- Auditimin e Tatim Fitimit për periudhën 2013 deri në 2017;
- Auditimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Nëntor 2014 deri më Korrik 2018.

Autoritetet tatimore kanë nxjerrë detyrime dhe penalitete në shumën totale LEK 25,595,507, të cilat u pranuan nga Dega dhe u paguan në 2019. Si rrjedhojë, Dega ka regjistruar një provigjion në vlerën e LEK 25,595,507 në pasqyrat financiare të 2018.